



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 1662 / Prot.

3

Vlorë më, 16.7.2024

VENDIM
Nr. 28, datë 26.07.2024

PËR
MIRATIMIN LOGOS, ÇERTIFIKATËS, DHE HIMNIT TË UNIVERSITETIT
"ISMAIL QEMALI", VLORE ME RASTIN E KREMTIMIT TË 30 VJETORIT TË
THEMELIMIT TË UV-SË

Në mbështetje të nenit 38, të Ligjit nr. 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 19, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, si dhe referuar propozimit ardhur me shkresën nr.1635 prot, datë 23.07.2024, Senati Akademik në mbledhjen e datës 26.07.2024,

VENDOSI:

1. Të miratojë logon, himnin e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, si dhe 2 modele certifikatash që do të jepen me rastin e ceremonisë së 30 vjetorit të themelimit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof.Dr. ROLAND ZISI





REPUBLIKA E SHQIPERISE

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
KOMISIONI - 30 VJETOR UV

Nr. 1635 Prot.

Vlorë më, 23.7.2024

Lënda: Propozim mbi përcaktimin e logos, certifikatës, poster dhe himnin e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë në kuadër të ceremonisë së 30 vjetorit të themelimit të UV-së.

**REKTORIT TË UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI", VLORE
PROF.DR. ROLAND ZISI**

KËTU

Në kuadër të festimeve të 30 vjetorit të themelimit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë si dhe në zbatim të Urdhërit të Rektorit nr.15, datë 30.01.2024 "Për ngritjen e komisionit për organizimin e ceremonisë së 30 vjetorit të themelimit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë Komisioni Ad-Hoc i ngritur për mbarëvajtjen dhe koordinimin e të gjithë punës për organizimin e ceremonisë së 30 vjetorit të UV-së në mbledhjen e datës 12.07.2024, vendosi të miratojë versionin përfundimtar të himnit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, logon, posterin që do të shoqërojë njoftimet si dhe modelet e certifikatave që do të jepen për personalitete, personelin që ka kontribuar ndër vite (të cilat do të jepen sipas propozimeve të dhëna nga Njësitë kryesore) me rastin e festimeve të ceremonisë në kuadër të 30 vjetorit të themelimit të UV-së.

Bashkëlidhur gjeni modelet e propozuara nga ana e Komisionit për tu paraqitur për miratim të mëtejshëm pranë Senatit Akademik.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin,

**KRYETARI KOMISIONIT
Eloina TOZAJ**

Eloina Tozaj

CERTIFIKATË

NDERI
Doket

Jana Foxha

PËR KONTRIBUTE TË SPIKATURA GJATË KARRIERËS AKADEMIKE NË
UNIVERSITETIN 'ISMAIL QEMALI' VLORË DHE PËRKUSHTIMIN E TREGUAR NË
FORMIMIN E STUDENTËVE, KËRKIMIN SHKENCOR DHE CUARJEN PËRPARA TË
MISIONIT TË UNIVERSITETIT.

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
Shtator 2024



Rektor

Emër Mbiemër



CERTIFIKATË

MIRËNJOHJEJE

ijepet

Jana Faxha

PËR KONTRIBUTE TË SPIKATURA GJATË KARRIERËS AKADEMIKE NË UNIVERSITETIN 'ISMAIL QEMALI' VLORE DHE PËRKUSHTIMIN E TREGUAR NË FORMIMIN E STUDENTËVE, KËRKIMIN SHKENCOR DHE CUARJEN PËRPARA TË MISIONIT TË UNIVERSITETIT.

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE

Shtator 2024



Emër Mbiemër

Rektor

30 VJETORI UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI"




VLORË

Pranë Rektoratit
Skele, Vlorë

4 TETOR, 2024 | 16.30





Himni i Universitetit "ISMAIL QEMALI" Vlorë

Teksti: Albert HABAZAJ

Strofa 1:

Vlora dritë e zemrës sime
Bukur shkruar historinë,
Sot marr krahë për fluturime
Të shenjtë e kam diturinë.

Universiteti ynë
Bekuar nga Plaku i Bardhë,
UNI VLORA "Ismail Qemali"
Emër qe na bën krenar.

Refreni:

Për ty rreh kjo zemra ime
Auditorët sot ke hapur,
Rrugën nis për fluturime
Universitet i dashur.

Krenar për emrin tënd,
Binjakë me pavaresinë,
Betohemi për atë flamur:
Do ta bëjmë ne Shqipërinë!

Strofa 2:

Në çdo kohë faqendritur
Mëmëzonja Vlora jonë,
Student' në rrugën e dijes
UNI VLORA po na fton.

Buzë detit lindur, rritur
Portë e hapur je gjithmon',
Krahëhapur na ke pritur,
Jemi si në shtëpinë ton'.

Refreni:

Për ty rreh kjo zemra ime
Auditorët sot ke hapur,
Rrugën nis për fluturime
Universitet i dashur.

Krenar për emrin tënd,
Binjakë me pavarësinë,
Betohemi për atë flamur:
Do ta bëjmë ne Shqipërinë!

Vlorë, 17.07.2024